23628

REPUBLIKA E SHQIPERISE

GJYKATA E RRETHIT TIRANE

Nr.i vendimit 23628

Data

VENDIM
PER REGJISTRIMIN E PERSONIT JUTIDIK

Sot ne daten 18.4.2000 une gjyqtarja [signature] pasi shqyrtova kerkesen e bere nga Sami Maksut Gjergji lindur ne 1954, me pasaport nr.0281514 dhe Emiliano Sami Gjergji lindur ne 1981, me pasaport nr.1237332, te dy banues ne Durres me te cilen kerkohet regjistrimi si person juridik i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "OVVITAL sh.p.k." dhe dokumentat qe e shoqerojne kete kerkese,

KONSTATOVA

Kerkuesit Sami Gjergji dhe Emiliano Gjergji kane themeluar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emertimin "OVVITAL sh.p.k." me qender ne lagjen Nr.1 Durres ,me kapital themeltar prej 100.000 lek me kontributin e te dyve me nga 50 % secili,me afat veprimtarie per 30 vjete dhe me objekt te veprimtarise se saj Rritja eshpendeve per prodhim vezesh dhe mishi dhe tregetimi i tyre brenda dhe jashte vendit.Prodhiumi dhe tregetimi brenda dhe jashte vendit i te gjitha llojeve te ushqimeve per kafshe, importimi dhe eksportimi i artikujve te ndryshem dhe i materialeve qe kane te bejne me kete veprimtari dhe i teknollogjise.Shoqeria mund te ushtroje edhe cdo lloj veprimtarie tjeter ekonomike, tregetare dhe financiare qe gjykohet e nevojshme per realizimin e objektivave te shoqerise.Shoqeria administrohet nga EMILIANO SAMI GJERGJI.

Duke qene se veprimtaria e shoqerise eshte veprimtari ligjore dhe aktet e dokumentat e paraqitura jane te rregullta dhe konforme kerkesave te ligjit,ka vend te pranohet kerkesa e tyre.

PER KETO ARESYE

Ne baze te nenit 37 e vijues te Ligjit Nr.7638 date 19.XI.1992 dhe te Ligjit Nr.7667 date 28.I.1993,

VENDOSA

Te regjistroj si person juridik Shoqerine me pergjegjesi te kufizuar me emertimin "OVVITAL sh.p.k." me qender ne lagjej nr.1 Durrres , me ortake SAMI MAKSUT GJERGJI dhe EMILIANO SAMI GJERGJI, me kapital 100.000 leke,me pjesemarrje ne kapital te dy ortakeve ne pjese te barabarta nga 50 % secili,me afat veprimtarie prej 30 vjetesh, me objekt te veprimtarise:Rritja e shpendeve per prodhim vezesh dhe mishi dhe tregetimi i tyre

brenda dhe jashte vendit.Prodhimi dhe tregetimi brenda dhe jashte vendit i te gjitha llojeve te ushqimeve per kafshet, importimi dhe eksportimi i artikujve te ndryshem, te materialeve qe kane te bejne me kete veprimtari dhe i teknollogjise.Shoqeria gjithashtu mund te ushtroje edhe cdo lloj veprimtarie tjeter ekonomike,tregetare dhe financiare qe gjykohet e nevojshme ose e debishme per realizimin e objektivave te shoqerise.Shoqeria do te administrohet nga administratoret EMILIANO SAMI GJERGJI.

Kunder ketij vendimi mund te behet ankim ne Gjykaten Apelit Tirane.

G J Y Q T A R E

/ Myzhenda Doga /

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
NR. 23628/1

## VENDIM
## I GJYQTARES SE VETME

Sot, me date 18.05.2001 une gjyqtare e GJykates se Rrethit Tirane, pasi mora ne shqyrtim kerkesen e kerkuesit Emiliano Gjergji, me cilesine e administratorit te shoqerise OVVITAL SHPK, i cili kerkon te depozitoje Vendimet e Asamblese se ortakeve date 21.2.2001 dhe ;

### KONSTATOVA:

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "OVVITAL" SHPK e regjistruar ne Zyren e Regjistrit Tregtar Tirane, me dy ortak Sami Gjergji dhe Emiliono Gjergji, me kapital themeltar 100.000 leke dhe me seli ne Durres.

Sipas Vendimit te Asamblese se Ortakeve te shoqerise OVVITAL shpk eshte vendosur te largohet ortaku Sami Gjergji nga kjo shoqeri dhe kuotat e kapitalit te tij me te drejten e parablerjes i ka ortaku tjeter z. Emiliano Gjergji, i cili me blerjen e kuotave prej 50 % me vlefte 50.000 leke behet ortak e administrator i shoqerise OVVITAL SHPK , me kuota 100 % me vlefte 100.000 leke.

Kerkesa e tij per te bere ndryshimet e nevojshme ne Skeden perkatese te kesaj shoqerie eshte e drejte dhe si e tille ajo duhet te pranohet.

### PER KETO ARSYE :

Ne baze te ligjit 7638, date 19.11.1992 per shoqerite Tregtare si dhe ligjit 7667, date 28.01.1993 Per regjistrin tregtar ;

### VENDOSA:

Pranimin per depozitimin prane Zyres se Regjistrit Tregtar, ne Skenden Perkatese te shoqerise OVVITAL SHPK te Vendimit te Asamblese se Ortakeve te dates 21.02.2001, ku eshte vendosur largimi i ortakut Sami Gjergji . Duke blere kuotat ortaku z. Emiliano Gjergji ne 100 kuota me vlefte 100.000 leke ortak e administrator i vetem i shoqerise OVVITAL SHPK mbetet z. Emiliano Gjergji.

Urdherohet Zyra e Regjistrit Tregtar per te bere ndryshimet e nevojshme prane skendes se kesaj shoqerie ne kollonen nr.2, 4 dhe 5 duke u ndare regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

GJYQTARE
Amalia Cafo

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**

**GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE**

**NR.** 23628/2

## VENDIM

## I GJYQTARES SE VETME

Sot, me date 04.03.2003, une gjyqtare e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, pasi mora ne shqyrtim kerkesen e kerkuesit z.Emiliano Gjergji , i cili kerkon depozitimin e Vendimit te Ortakut te Vetem te "OVVITAL",date 17.02.2003 dhe ;

**K O N S T A T O V A;**

Me vendimin nr.23628, date 11.04.2000 te Gjykates se Rrethit Tirane eshte regjistruar si person juridik shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "OVVITAL" shpk me ortak Sami Gjergji dhe Emiliano Gjergji me administrator Emiliano Gjergji, me seli ne Durres.

Me vendimin nr.23628/1, date 18.05.2001 te Gjykates se Rrethit Tirane eshte vendosur largimi i ortakut Sami Gjergji dhe shoqeria OVVITAL SHPK mbetet me ortak dhe administrator te vetem z. Emiliano Gjergji.

Me vendimin nr.1, date 17.02.2003 te Ortakut te Vetem eshte vendosur te ndryshoje selia e shoqerise nga Durres, lagja nr.1, ne fshatin Kulle te Bashkise Sukth Durres. Caktohet administrator i jashtem z. Kristaq Prence, i dtl. 1945, me banim ne Tirane.

Kerkesa e tij per t'u bere ndryshimet perkatese ne Skeden e kesaj shoqerie ne Zyren e Regjistrit tregtar eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

**PER KETO ARSYE ;**

Ne baze te ligjit 7667, date 28.1.1993 per Regjistrin Tregtar e formalitetet qe duhen plotesuar ne te ;

**V E N D O S A ;**

Pranimin e kerkeses.

Depozitimin e Vendimit te Ortakut te Vetem te shoqerise "OVVITAL" shpk mbajtur me date 17 shkurt 2003 ku eshte vendosur ndryshimi i selise nga lagja nr.1 Durres ne fshatin Kulle te Bashkise Sukth Durres si dhe detyren e administratorit tani do ta kryej z. Kristaq Orence.

Duke urdheruar kete zyre per te bere ndryshimet e nevojshme ne Skeden perkatese te kesaj shoqerie ne kollonen 4, 5 me numer rendor 3,duke u ndare regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

*G J Y Q T A R E*

*Anila Capo*

23628

# URDHER RREGJISTRIMI

- Emertimi I Shoqerise : [illegible] Sh.p.k
- Selia : L1 Durres
- Objekti : [illegible]
- Kapitali : 100000 leke
- Administrator : [illegible] - Banues L1 Durres
- Kohezgjatia : mbi 30 vjet
- Statuti : 7 flete
- Akt - Themelimi : 2 flete
- Data e nenshkrimit : ~~7~~ 11.4.2000
- Data e Rregjistrimit : 18.4.2000

GJYQTARE

[illegible]

# AKT THEMELIMI

Ne Durres sot ne daten 23 Mars te vitit 2000 para meje avokatit Jani Lezo me qender ne Durres, u paraqiten:

1.SAMI GJERGJI i biri i Maksutit i datelindjes 1954 banues ne Durres, me zotesi te plote per te vepruar me pasaport me Nr.0281514. dhe

2.EMILIANO GJERGJI i biri i Samiut i datelindjes 13.12.81 me banim ne Durres, me zotesi te plote per te vepruar me pasaport me nr.1237332.

te cilet kerkuan redaktimin e ketij akti per themelimin e nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar si me poshte:

## Neni 1

Shoqeria me pergjegjesi tekufizuar qe krijohet me kete akt emertohet "OVVITAL sh.p.k.", emertim qe do te jete ne emblemen e saj, ne vulen dhe ne te gjitha dokumentat e tjera.

## Neni 2

Qendra e shoqerise do te jete ne qytetin e Durresit lagja nr.1.

## Neni 3

Afati i veprimtarise se shoqerise caktohet per 30 vjete, duke patur si date fillimi daten e regjistrimit te saj ne organet kompetente.

## Neni 4

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete:

- Rritja e shpendeve per prodhim vezesh dhe per mish, si dhe tregetimi i tyre brenda dhe jashte vendit.
- Prodhimi dhe tregetimi brenda dher jashte vendit i te gjitha llojeve te ushqimeve per kafshet.
- Importimi dhe eksportimi i artikujve te ndryshem dhe i materialeve qe kane te bejne me kete veprimtari dhe i teknollogjise.

Shoqeria mund te ushtroje edhe cdo lloj veprimtarie tjeter ekonomike, tregetare dhe financiare qe gjykohet e nevojshme per realizimin e objektivave te shoqerise.

## Neni 5

Kapitali themeltar i shoqerise do te jete 100.000 (njeqinde mije) leke, i ndare ne 100 kuota me 1000 leke secila.

Ne kete kapital ortaket themelues kontribuojne si me poshte:

- Sami Gjergji me kontribute ne para ne masen 50.000 leke ose 50% te kapitalit.
- Emiliano Gjergji me kontribute ne para ne masen 50.000 leke, ose 50% te kapitalit.

Kapitali i shoqerise si me siper eshte shlyer plotesisht.

Neni 6

Ne raport me pjesemarrjen ne kapitalin e shoqerise ortaket do te marrin pjese ne ndarjen e fitimeve dhe ne pergjegjesi ndaj detyrimeve.

Neni 7

Me kete akt themelimi, administrator i shoqerise caktohet Z.Emiliano Gjergji.

Neni 8

Baza ligjore e shoqerise eshte ligji per shoqerite tregetare dhe Statuti i saj.

Neni 9

Ky akt u redaktua ne kater kopje dhe pasi u lexua dhe u pranua nga ortaket themelues, firmoset pa kundershtim.

ORTAKET THEMELUES

SAMI GJERGJI — EMILIANO GJERGJI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE DURRES
Nr.rep. 127 Nr.kolek. 24

V E R T E T I M

Ne Durres sot ne daten 11-04-2000 para meje Milto J.Dado noter me qender ne Durres, u paraqiten personalisht Sami Gjergji i biri i Maksutit i datelindjes 1954 me pasaport nr.0281514 dhe Emiliano Gjergji i biri i Samiut i datelindjes 1981, me pasaport Nr.1237332, te dy me zotesi te plote per te vepruar, te cilet ne pranine time firmosen kete akt themelimi.Une noteri vertetoj.

N O T E R I
MILTO J.DADO

# S T A T U T

## I SHOQERISE "OVVITAL sh.p.k." DURRES

### Neni 1

Shoqeria "OVVITAL Sh.p.k." eshte krijuar ne baze te kontrates se themelimit ndermjet SAMI MAKSUT GJERGJIT i datelindjes 1954 me banim ne Durres, me pasaport nr.0281514 dhe EMILIANO SAMI GJERGJI i datelindjes 13.12.1981,me pasaport nr.1237332 me banim ne Durres.

### Neni 2

### EMERTIMI I SHOQERISE

Shoqeria ne fjale emertohet "OVVITAL Sh.p.k.",emertim i cili do te jete ne emblemen e saj, ne vulen zyrtare dhe ne te gjithe dokumentacionin e saj, si dhe ne marredheniet me personat e tjere fizike e juridik te vendit dhe te huaj.

### Neni 3

### QENDRA E SHOQERISE

Qendra administrative e shoqerise do te jete ne qytetin e Durresit - Shqiperi, lagja nr.1 rruga e Curilave.

Me vendim te asamblese se ortakeve, qendra e shoqerise mund te ndryshohet ne cdo kohe, sipas nevojave te shoqerise, si dhe mund te krijohen filiale e dege edhe ne vende te tjera.

### Neni 4

### OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqeria ka si objekt te veprimtarise se saj:

- Rritja e shpendeve per prodhim vezesh dhe per mish, si dhe tregetimi i tyre brenda dhe jashte vendit.
- Prodhimi dhe tregetimi, brenda dhe jashte vendit, i te gjithqa llojeve te ushqimeve per kafshet.
- Importimi dhe eksportimi i artikujve te ndryshem dhe i materialeve qe kane te bejne me kete veprimtari dhe i teknollogjise.
- Shoqeria, gjithashtu, mund te ushtroje edhe cdo lloj veprimtarie tjeter ekonomike, tregetare e financiare qe gjykohet e nevojshme dhe e dobishme per realizimin e objektivave te shoqerise.

Me vendim te Asamblese se ortakeve, objekti i veprimtarise se shoqerise mund te ndryshoje,duke hequr ose shtuar veprimtari te tjera.

## Neni 5

## ORTAKET DHE PJESEMARRJA NE KAPITAL

Ortaket e kesaj shoqerie jane:

1)SAMI MAKSUT GJERGJI i datelindjes 1954, me banim ne Durres.

2)EMILIANO SAMI GJERGJI i datelindjes 1981, me banim ne Durres.

Kapitali fillestar i shoqerise, mbi te cilon krijohet kjo shoqeri eshte 100.000 (njeqinde mije) leke, i ndare ne 100 kuota me vlere 1000 leke secila.

Ne kete kapital ortaku SAMI MAKSUT GJERGJI kontribuon me 50.000 leke qe perfaqeson 50 % te kapitalit,duke zoteruar keshtu 50 kuota.

EMILIANO SAMI GJERGJI kontribuon me 50.000 leke, qe perfaqesojne 50% te kapitalit, duke zoteruar keshtu 50 kuota.

Kapitali i shoqerise eshte i shlyer plotesisht.

.Kapitali i shoqerise mund te shtohet me te ardhurat e aktivitetit ekonomik te shoqerise, dhe ne rast nevoje edhe me derdhje suplementare qe ortaket bejne ne permasa poroporcionale me kuotat fillestare te derdhura.

## Neni 6

## PERSONALITETI JURIDIK

Shoqeria "OVVITAL Sh.p.k." fiton personalitetin e vet jurdik me regjistrimin e saj ne organet kompetente shqiptare, ne baze te legjislacionit shqiptar.

E gjithe veprimtaria e shoqerise do te mbeshttet ne legjislacionin shqiptar, ne kontraten e themelimit dhe ne dispozitat e ketij statuti.

## Neni 7

## TE DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKEVE

Ortaket kane te drejte:

- Te marrin pjese ne mbledhjet e Asamblese se ortakeve dhe te zbatojne vendimet dhe detyrat e Asamblese.
- Te marrin pjese ne rezultatet e aktivitetit ekonomik te shoqerise sipas kuotave te percaktuara me larte.
- Te marrin informacion te plote lidhur me aktivitetin ekonomik e financiar te shoqerise, per gjendjen e pasurise se saj, te ardhurat dhe humbjet.
- Te bejne propozime dhe te marrin pjese ne diskutimin e problemeve ne Asamblene e ortakeve dhe ne organet e tjera vendimore te shoqerise.

Ortaket kane keto detyra:

- Te derdhin kuotat he kontributet plotesuese ne kapitalin e shoqerise, sipas kontrates, statutit dhe vendimevete Asamblese se

ortakeve.

- T'i japin shoqerise te gjitha informacionet e nevojshme per probleme qe kane te bejne me veprimtarine dhe aktivitetin e shoqerise.

Neni 8

Shoqeria ka bilancin e vet AUTONOM dhe vepron ne baze te kritereve te efektshmerise dhe te rentabilitetit.

Neni 9

Shoqeria mban kontabilitetin e saj dhe harton bilancen financiare ne afatet dhe ne menyren qe percaktohet ne legjislacionit te Republikes se Shqiperise.

Neni 10

Te ardhurat e shoqerise qe mbeten pasi zbriten traksat, qe parashikohen ne legjislacionin shqiptar, si dhe shumat e nevojshme per perberjen dhe shtimin e fondeve te shoqerise,shperndahen ne perputhje me vendimin qe merre Asambleja e ortakeve.

Neni 11

DREJTIMI ADMINISTRATIV

Organi me i larte administrativ i shoqerise eshte ASAMBLEJA E ORTAKEVE.Numri i votave te cdo ortaku ne mbledhjet e Asamblese percaktohet me numrin e kuotave qe zoteron ne kapitalin e shoqerise.

Mbledhjet e Asamblese se ortakeve behen sa eshte eshte e nevojshme, por ne cdo rast jo me pak se nje here ne vit dhe jo me vone se tre muaj nga mbyllja e vitit financiar.

Neni 12

Asambleja e ortakeve ka kompetence te vendos per te gjitha problemet qe kane te bejne me aktivitetin e shoqerise.Ne kompetence eskluzive te Asamblese se ortakeve jane keto ceshtje:

- Percaktimi i drejtimeve kryesore te veprimtarise se shoqerise, miratimi i planeve dhe llogaritjet per plotesimin e tyre.
- Aprovimi i normave dhe i rregullave per funksionimin e brendeshem te shoqerise,duke miratuar dhe shpallur rregulloren e brendshme.
- Cakton administratorin e vetem te shoqerise.
- Krijon organet e domosdoshme per funksionimin e shoqerise dhe percakton kompetencat e tyre.
- Percakton regjimin e perdorimit te fondeve, shperbdarjen e te ardhurave dhe percakton menyren e mbylljes se humbjeve.
- Vendos per krijimin e filialeve dhe perfaqesive te shoqerise, si dhe per mbylljen e aktivitetit te tyre kur e sheh te nevojshme.

- Aprovon rregulla proceduriale per funksionimi e vet Asamblese.

- Percakton rregulla per menyren e shperndarjes se te ardhurave ne valute qe jane lirisht te konvertueshme dhe qe mbeten ne fund te aktivitetit total.

- Vendos per financimin e investimeve te vogla ose me afat te gjate.

Ne kompetence eskluzive te Asamblese se Jashtezakonshme jane keto ceshtje:

- Shqyrtimi i propozimeve per ndryshimin dhe modifikimin e statutit te shoqerise.

- Shqyrtimi i propozimeve per ndryshime themelore te vleres se kapitalit shoqeror.

- Shqyrtimi i propozimeve per ndryshimin e kuotave te pjesemarrjes se otakeve ne kapitalin shoqeror.

- Cakton masen (vleren), menyrat dhe kufirin e derdhjes se kuotave suplementare nga ana e ortakeve.

- Shqyrton dhe vendos per probleme qe kane te bejne me daljen e ortakeve nga shoqeria, ose me nderprerjen e aktivitetit te shoqerise.

Neni 13

Vendimet e Asamblese se zakonshme te ortakeve jane te vlefshme ne rast se per to voton shumica e kapitalit te shoqerise.

Vendimet e Asamblese se Jashtezakonshme jane te vlefshme kur per to voton 3/4 e kapitalit te shoqerise.Cdo ortak ka te drejten e nje vote per cdo kuote qe zoteron.Ne rast barazimi te votave propozimi quhet i refuzuar.

Vendimet e Asamblese se ortakeve jane te vlefshme edhe per ortaket qe nuk kane marre pjese ne mbledhje dhe per ata qe kane votuar kundra.

Ne rast nevoje nje ortak mund te perfaqesohet ne mbledhjet e Asamblese se ortakeve me anen e perfaqesuesve, te cilet emerohen prej tyre me prokure te posacme me shkrim.

Neni 14

Shoqeria "OVVITAL Sh.p.k." mund te krijoje filiale dhe perfaqesi jashte qendres se saj, brenda dhe jashte teritorit te Republikes se Shqiperise

Neni 15

Administrimi i perditeshem i shoqerise realizohet me anen e administratoreve te cilet emerohen nga Asambleja e ortakeve.

Administratoret jepin llogari para Asamablese se ortakeve dhe jane pergjegjes per te gjithe veprimtarine e shoqerise.Ata njekohesisht perfaqesojne shoqerine ne marredhenie me te tretet si dhe perpara gjykatave kompetente per probleme penale dhe civile.

Administratori ka kryesisht keto detyra:

- Merre masa per plotesimin e planeve korente dhe te perspektives.

- Organizon punen per pergatitjen dhe zbatimin e vendimeve te organeve vendimore te shoqerise dhe paraqet raporte me shkrim per menyren e plotesimit te tyre.

- Ka te drejte te disponoje pasurine e shoqerise dhe ta perdore ate (perfshire ketu edhe mjetet financiare), brenda kufijve te percaktuara nga Asambleja e ortakeve dhe te shesi ato objekte qe nuk pengojne shoqerine te realizoje objektin e saj.

- Nenshkruan ne emer te shoqerise kontrata dhe akt marreveshje te ndryshme dhe merre masa per zbatimin e tyre.

- Perfaqeson shoqerine ne marredhenie me persona te tjere fizike e juridik te vendit dhe te huaj.

- Administratori ka te drejte te vendos per te gjitha ceshtjet e tjera qe lidhen me aktivitetin dhe administrimin e zakoneshem te shoqerise dhe qe nuk jane ne kompetencen eskluzive te Asamblese se ortakeve.

- Administratori keto detyra mund tua kaloje edhe personave te tjere jo ortak, me vendim te asamblese dhe me prokure noteriale.

## Neni 16

## KONTROLLI EKONOMIKO-FINANCIAR

Kontrolli ekonomiko-financiar mbi aktivitetin e shoqerise dhe te filialeve te saj behet nga ekspert kontabel ne perputhje me legjilacionin ne fuqi.

## Neni 17

Viti financiar mbyllet me 31 dhjetor te cdo viti.Ne fund te cdo viti financiar, administratori, nepermjet financiereve duhet te ndjerre bilancin sipas afateve dhe menyres se percaktuar ne ligj,i shoqeruar ky bilanc edhe me nje relacion shkoqites per ecurine e veprimtyarise ekonomike te shoqerise.

## Neni 18

Fitimi neto qe do te rezultoje nga bilanci i shoqerise do te ndahet si me poshte:

Nje pjese e fitimit vecohet per tu perdorur si fond rezerve, madhesia dhe menyra e perdorimit te tij percaktohen nga Asambleja e ortakeve. Pjesa tjeter e fitimit ndahet midis ortakeve ne raport me pjesemarrjen e tyre ne kapitalin e shoqerise.Ortaket mbeten pergjegjes per detyrimet e shoqerise me prqindjen e kapitalit te investuar.

## Neni 19

## SHPERNDARJA DHE LIKUJDIMI

Aktiviteti i shoqerise merr fund kur bilancet kontabel

rezultojne jo rentabel per tre vjete rradhazi,apo kur ortaket terhiqen nga shoqeria sipas parashikimit ne kontrate, ose kur mbaron afati i veprimtarise se shoqerise.

Neni 20

Per te percaktuar te drejtat dhe detyrimet e cdo ortaku qe largohet,shoqeria bene bilancin ne momentin e daljes se ortakut, duke bere vleresimet ne baze te kuotave te investuara.Ortakut qe largohet nuk i kthehen kuotat, per aresye se ato u shiten ortakeve te tjere.

Neni 21

Kur arrihet ne perfundimin se shoqeria duhet te likujdohet, Asambleja e ortakeve, cakton nje ose disa likujdatore,duke percaktuar kompetencat dhe menyren e shperblimit te tyre.

Neni 22

Pasuria e shoqerise si dhe mjetet monetare disponibel, ose ato qe nxirren nga shitja e pasurise, pasi shlyhen detyrimet ndaj kreditoreve, ne rast se ka te tille, u shperndahen ortakeve ne perpjestim me perqindjet e pjesemarrjes ne kapitalin e shoqerise.

Neni 23

Likujdimi ose shkrirja e filialeve te shoqerise, behet ne te njejten menyre si edhe likujdimi i vet shoqerise.

AFATI I VEPRIMTARISE

Neni 24

Shoqeria eshte krijuar per te ushtruar aktivitetin per nje periudhe prej 30 (tridhjete) vjetesh.
Me vendim te Asamblese ky afat mund te zgjatet edhe per nje periudhe tjeter

Neni 25.

Cdo mosmarreveshje qe mund te lindi midis ortakeve, ne rast se nuk mund te zgjidhet me mirekuptim midis tyre, organi kompetente per zgjidhjen e tyre do te jete Gjykata e rrethit te Durresit.

O R T A K E T

SAMI GJERGJI

EMILIANO GJERGJI

REPUBLIKA E SHQIPERISE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERTISE DURRES
Nr.rep. 831 Nr.kolek. 192

VERTETIM

Ne Durres sot ne daten 11.04.2000 ne zyren time para meje noterit MILTO J. DADO u paraqiten personalisht SAMI MAKSUT GJERGJI i datelindjes 1954, banues ne Durres me pasaport nr.0281514 dhe EMILIANO SAMI GJERGJI i datelindjes 1981 banues ne Durres, me pasaport nr.1237332, te cilet deklaruan se ky statut eshte perpiluar sipas porosive te tyre dhe firmosen ne pranine time.Une noteri vertetoj.

NOTERI
MILTO J.DADO

PULLE TAKSE
SHQIPERISE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA Tirane
NR. 435 Rep.

# VERTETIM

Vertetohet se sot me date 29.02.2000 para meje noteres u derdh shumen 100.000 leke per shoqerine ne krijim e siper **OVYITAL** shpk, bazuar ne ligjit 7638, date 19.11.1992 "PER SHOQERITE TREGTARE "shume te cilen do ta terheq mbas regjistrimit te saj ne REgjistrin Tregtar te Gjykates se Rrethit Tirane.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
AFRODHITI GJEBERO
NOTERE
TIRANE

З А. Сора
17.05.2001

17 MAG 2001

K E R K E S E

KERKUESI:EMILIANO GJERGJI i biri i Samiut i datelindjes 1981, me banim ne Durres lagja nr.1.

OBJEKTI I KERKESES

Te pasqyrohet ne Regjistrin Tregetar vendimi nr.1 date 21.2.2001 i Asamblese se ortakeve te shoqerise "OVVITAL sh.p.k."me qender ne Durres pr disa ndryshime ne statutin e kesaj shoqerie,ne baze te ligjit Nr.7667 date28.1.1993.

GJYKATES SE RRETHIT

T I R A N E

Asambleja e ortakeve e shoqerise "OVVITAL sh.p.k." Durres ne mbledhjen e saj te dates 21.2.2001, me unanimitet vendosi qe ortaku Sami Gjergji te shes kuotat e tij me vlefte 50.000 leke ortakut tjeter te kesaj shoqerie Emiliano Gjergji, shoqeria te vazhdoje aktivitetin e saj me ortak te vetem kete te fundit, qe eshte dhe administrator i vetem i shoqerise dhe ne raport me kete gjendje te re te behet edhe ndryshimet perkatese ne nenin 5 te Statutit te shoqerise.

Per provimin e sa me siper, bashkelidhur me kete kerkese ju paraqesim:

Nje kopje te vendimit te Asamblese se ortakeve nr.1 date 21.2.2001.

Nje kopje te kontrates noteriale per shitblerjen e kuotave.

Prandaj legjitimohem te kerkoj qe ky vendim i asamblese se ortakeve te pasqyrohet edhe ne Regjistrin Tregetar, me qellim qe ky vendim te marre fuqi ligjore konforme dispozitave te ligjit nr.7638 date 19.11.1992.

ADMINISTRATORI
EMILIANO GJERGJI

SHOQERIA "OVVITAL" Sh.p.k.
D U R R E S

# V E N D I M

Nr. 1 date 21.2.2001

Asambleja e ortakeve te shoqerise " OVVITAL sh.p.k." me qender ne qytetin e Durresit, ne baze te nenit 11 te Statutit te Shoqerise, u mblodh sot ne daten 21.2.2001 ne mbledhjen e saj te jashtezakonshme me pjesemarrjen e ortakeve SAMI MAKSUT GJERGJI dhe EMILIANO SAMI GJERGJI dhe, pasi analizoi problemet e parashikuara ne rendin e dites, me unanimitet

## V E N D O S I

1)Te lejoje ortakun SAMI MAKSUT GJERGJI qe te shes kuotat qe zoteron ne kapitalin e kesaj shoqerie, qe ne baze te nenit 5 te Statutit te shoqerise jane 50 kuota me vlefte 50.000 leke dhe largimin e tij nga ortakeria e kesaj shoqerie.

2)Te lejoje ortakun EMILIANO SAMI GJERGJI qe te bleje kuotat e siperme, duke u perpiluar per kete qellim kontrate shitblerje noteriale.

Ne kete menyre EMILIANO SAMI GJERGJI mbetet ortak i vetem i shoqerise "OVVITAL sh.p.k.",duke patur njekohesisht edhe detyren e administratorit te vetem te kesaj shoqerie.

3)Per sa siper te behen ndryshimet perkatese edhe ne dispozitat e Statutit te Shoqerise dhe konkretisht:

a.Neni 5 i statutit ndryshon si vijon:

"Ortaku i vetem i shoqerise eshte EMILIANO SAMI GJERGJI i datelindjes 1981, me banim ne Durres.

Kapitali fillestar i shoqerise eshte 100.000 leke i ndare ne 100 kuota me vlefte 1000 leke secila zoterohet teresisht nga EMILIANO SAMI GJERGJI dhe eshte i shlyer plotesisht.

Paragrafi i fundit i nenit 5 mbetet i pandryshuar.

Dispozitat e tjera te statutit te shoqerise mbeten te pandryshuara dhe te vlefshme edhe per shoqerine me nje ortak te vetem sipas ketij vendimi.

O R T A K E T

SAMI GJERGJI | EMILIANO GJERGJI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA E NOTERISE DURRES
Nr.Rep. 423 Nr.Kol. 74

# KONTRATE SHITBLERJE

Ne Durres sot ne daten 21 (Njezete enje) te muajit Shkurt te vitit 2001 (dy mije e nje), para meje Milto J.Dado noter me qender ne Durres, rruga A.Goga, u paraqiten personalisht:

1.SAMI GJERGJI i biri i Maksutit i datelindjes 1954, banues ne Durres lagja nr.1, i njohur prej meje me pasaport nr.0281514, me zotesi te plote per te vepruar, ne cilesine e shitesit dhe,

2.EMILIANO GJERGJI i biri i Samiut i datelindjes 1981, banues ne Durres me pasaport nr.1237332, me zotesi te plote per te vepruar,

te cilet kerkuan redaktimin e kesaj kontrate per shitblerjen e kuotave ndermjet ortakeve te shoqerise "OVVITAL sh.p.k.", si me poshte:

Une Sami Gjergji si ortak i shoqerise "OVVITAL sh.p.k. ne baze te statutit te shoqerise zoteroje 50 kuota me vlefte 50.000 leke, te cilat me deshire te plote ja shes ortakut tjeter te kesaj shoqerie Emiliano Gjergji, i cili si bashkeortak gezon te drejten e parablerjes per to.

Une Emiliano Gjergji ortak i shoqerise "OVVITAL sh.p.k.", pranoj te bleje 50 kuotat e shitura nga Sami Gjergji me vleften 50.000 leke, te cilat i kam paguar me leke ne dore.

Une Sami Gjergji vertetoj se kam marre nga Emiliano Gjergji shumen 50.000 leke, duke hequr keshtu dore nga zoterimi i 50 kuotave ne shoqerine "OVVITAL sh.p.k.".

Kontrata u redaktua ne kater kopje dhe pasi u lexua me ze te larte dhe u pranua permbajtja e saj, u firmos nga te dy palet dhe nga une noteri sipas ligjit.

SHITESI
SAMI GJERGJI

BLERESI
EMILIANO GJERGJI

NOTERI
MILTO J. DADO

26

# K E R K E S E

23.628

KERKUES: SAMI GJERGJI i biri i Maksutit lindur ne 1954, banues ne Durres, me pasaport nr.0281514.
EMILIANO GJERGJI i biri i Samiut lindur ne 1981, banues ne Durres me pasaport nr.1237332.

## OBJEKTI I KERKESES

Kerkohet regjistrimi si person juridik i Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "OVVITAL sh.p.k."ne baze te ligjit nr.7638 date 19.11.1992 dhe ligjit nr.7667 date 28.1.1993.

GJYKATES SE RRETHIT

T I R A N E

Ne baze te aktit te themelimit,ndermjet ortakeve Sami Maksut Gjergji dhe Emiliano Sami Gjergji,u themelua shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "OVVITAL sh.p.k." me qender ne lagjen nr.1 Durres, me afat veprimtarie 30 vjete,me kapital themeltar 100.000 leke i formuar me kontributin e dy ortakeve te siperme me nga 50 % secili, ,me objekt te veprimtarise se saj:Rritja e shpendeve per prodhim vezesh dhe mishi dhe tregetimi i tyre brenda dhe jashte vendit.Prodhimi dhe tregetimi brenda dhe jashte vendit i te gjitha llojeve te ushqimeve per kafshe,importimi dhe eksportimi i artikujve te ndryshem dhe i materialeve qe kane te bejne me kete veprimtari dhe i teknollogjise.Shoqeria mund te te ushtroje edhe cdo lloj veprimtarie tjeter ekonomike, tregetare he financiare qe gjykohet e nevojshme per realizimin e objektiveve te shoqerise.Shoqeria do te administrohet nga administratori EMILIANO SAMI GJERGJI.

Bashkelidhur ju paraqesim nje kopje te Aktit te Themelimit, te Statutit te shoqerise dhe dokumentat e tjera.

Mbi sa siper kerkojme te regjistrohet ne Regjistrin Tregetar Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "OVVITAL sh.p.k."

K E R K U E S I T

SAMI GJERGJI      EMILIANO GJERGJI

SHOQERIA "OVVITAL"Sh.p.k.

D U R R E S

# VENDIM

Nr.1 date 17.2.2003

Sot ne daten 17.2.2003 ne seline e Shoqerise, une Emiliano Gjergji, ortaku i vetem i Shoqerise, ne baze te nenit 12 te Statutit te shoqerise dhe te dispozitave te ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare",

## VENDOSA

Te beje ndryshimet e meposhtme ne statutin e shoqerise:

1.Te ndryshoj nenin 3 te statutit qe bene fjale per seline e shoqerise.Paragrtafi i pare i ketij neni ndryshohet si vijon: "Qendra administrative e shoqerise do te jete ne fshatin Kulle te Bashkise Sukth - Durres.

2. Ndryshohet neni 15 i statutit si vijon:

Paragrafi i trete i ketij neni nryshohet:"Emerohet administratori i shoqerise Zoti KRISTAQ PRENCE i detelindjes 01.08.1945 me banim ne rrugen Irfan Tomini Pall.40 Shk.I, Ap.7 Tirane, i cili kakryesisht ka keto detyra:

- Merre masa per plotesimin e planeve korente dhe te perspektives.

- Organizon punen per pergatitjen dhe zbatimin e vendimeve te orgneve vendimore te shoqerise dhe paraqet raporte me shkrim per menyren e plotesimit te tyre.

- Perfaqeson shoqerine ne marredheniet me personat e tjere fizike e juridik te vendit dhe te huaj.

- Merret me administrimin dhe drejtimin e perditeshem te puneve te shoqerise.

Per zbatimin e detyrave si administrator dhe per mbarevejtjen e puneve te shoqerise,ai eshte i detyruar ti raportoje me shkrim ortakut te vetem Z.Emiliano Gjergji cdo tre muaj.

ORTAKU I VETEM

EMILIANO GJERGJI

Emiliano Gjergji

REPUBLIKA E SHQIPERISE

DHOMA E NOTERISE DURRES

*Nr. Rep* 212

Durres, 17.02.2003

## VERTETIM

Vertetohet se eshte i vertete dhe autentik neneshkrimi i Z. Emiliano GJERGJI, i biri i Samiut , i dl. 13.12.1981 , titullar i pasaportes nr. 1237332, i vene ne Vendimin N.1 date 17.02.2003, qe i bashkengjitet ketij vertetimi.

NOTERI

MILTO J. DADO



SHOQERIA "OVVITAL" Sh.p.k.
DURRES

KERKESE

KERKUESI: Emiliano GJERGJI, i biri i Samiut , i dl. 13.12.1981, banues ne Durres, Shetitore "Taulantia",1, titullar i pasaportes nr. 1237332.

OBJEKTI I KERKESES: Depozitimi ne regjistrin Tregtar te Vendimit nr. 1 date 17.02.2003 te Ortakut te Vetem per disa ndryshime ne Statutin e Shoqerise, mbeshtetur ne ligjin nr. 7667 date 28.01.1993.

GJYKATES SE SHKALLES SE PARE
TIRANE

Me cilesine e Ortakut te Vetem te Shoqerise "OVVITAL" Sh.p.k. Durres, brenda kompetencave te mia kam marre vendimin nr. 1 date 17.02.2003 per disa ndryshime ne Statutin e kesaj Shoqerije lidhur me Seline e Shoqerise dhe emerimin e Administratorit te saj.

Me qellim qe keto ndryshime te pasqyrohen edhe ne dokumentacionin e Regjistrit Tregtar, Ju paraqesim kerkesen per sa siper.

KERKUESI
Emiliano Gjergji

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE DURRES
*Nr. Rep* 913

Durres, 17.02.2003

## VERTETIM

Vertetohet se eshte i vertete dhe autentik neneshkrimi i Z. Emiliano GJERGJI, i biri i Samiut, i dl. 13.12.1981, titullar i pasaportes nr. 1237332, i vene ne Kerkesen e bashkengjitur

NOTERI
MILTO J. DADO